



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 361/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Fatmir Xhelili nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

## V E N D I M

- I. **Pranohet** si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fatmir Xhelili nga koalicioni PDK-AAK-NISMA.
- II. **Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA në Vendvotimin: 2201E/02R.
- III. **Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.
- IV. **Halil Kurtishi** me nr. të letërnjoftimit [REDACTED], në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 2201E/02R, i ndalohej pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

## A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.06.2017, nga kandidati për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Fatmir Xhelili nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me të cilën pretendon se në qendrën e votimit 2201E/02R rezultojnë se kandidati në fjalë me numër rendor 37 ka pasur 55 vota të konfirmuara nga komisionarët dhe vëzhguesit por këto vota gabimisht janë regjistruar në FRK tek kandidati me nr 36 i të njëjtit subjekt.

Parashtruesi i ankesës si prova materiale bashkangjitur Formularin e Rezultateve të Kandidatëve për vendvotimin e lartcekur.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

#### **ankesa është e bazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkrësive të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 2201E/02R është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidati me nr.37, nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, Komuna e Shtimës, nuk ka asnjë votë, në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i ankesës i posedon 56 vota të vlefshme.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkritazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit, për pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, sepse Kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par.10 të LZP-së, Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë, ka bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesë nuk i janë regjistruar asnjë votë në FRK, ndonëse pas hetimeve të bëra nga paneli është vërtetuar se i njëjti i posedon 56 vota.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. 3 pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 361/2017 më datën 02.07.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

**Ymer Hoxha**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesë sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

